



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 11, nenin 12 paragrafi 1 dhe nenin 17 paragrafi 1 pika 0) të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetqeverisje Lokale /04 Qershor 2008/, Udhezimit Administrativ nr17/2019 Për krijimin dhe administrimin e Listes Alfabetike për emertime Listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal të adresave, si dhe nenin 40.paragrafi 2 në pikën 8) të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit 01nr.221-10781/21 të datës 02.04.2021, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-të rregullt për vitin 2021 të mbajtur më 30.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Për

Formimin e Komisionit për emrimin dhe riemrimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në Komunën e Klinës

1. Formohet Komisioni për emrimin dhe riemrimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në Komunën e Klinës në përberje prej (9) anëtarësh si vijon:

- | | | | |
|-----|-------------------|---|--------|
| 1.1 | Asdren Ramadani - | KK | anëtar |
| 1.2 | Sefa Morina - | KK | “ |
| 1.3 | Lirim Gashi - | KK | “ |
| 1.4 | Xhevshet Berisha- | KK | “ |
| 1.5 | Gazmend Dauti- | Përfaqësues nga komuniteti joshumicë | “ |
| 1.6 | Xhyle Halili- | Qendra Rinore “Ardhmerija” –përfaq. nga Shoqëria Civile | “ |
| 1.7 | Ali Rraci- | Historijan | “ |
| 1.8 | Shani Toqani- | Gjeograf | “ |
| 1.9 | Alban Gashi- | Përfaqësues për mbrojtjen e trashigimis kulturore | “ |

2. Emri i anëtarit të komisionit nga pika 1.6 Përfaqësuesi nga Shoqëria Civile, do të dërgohet me shkrim pas përcaktimit SHC për Përfundimin për përfaqësimin e tyre.
3. Anëtarët e komisionit nga pika 1 e këtij vendimi zgjedhen për mandat- kohëzgjatje të mandatit të anëtarëve të Kuvendit Komunal.
4. Kryesuesit dhe Zëvendës kryesuesi i Komisionit zgjedhen nga radhët e anëtarëve të komisionit me shumicë votash.
5. Detyrë e Komisionit nga pika 1 e këtij vendimi është: shqyrtimi i kërkesave për emertime të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike dhe pregatitja e propozimeve bazuar në kriteret përkatëse të përcaktuara me ligje dhe akte tjera nënligjore në fuqi, për Kuvendin e Komunës për marrjen e vendimit.

6. Mbeshtetje nga pika 1 e ketij vendimi do të ofroji Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjës së Mjedisit e sipas kërkesës edhe njesitë-drejtoritë tjera varsisht nga kërkesat.
7. Për zbatimin e ketij vendimi do të kujdesët Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Klinë.
8. Me hyrjen në fuqi të ketij vendimi do të shfuqizohët vendimi 01nr.351-4626/2014 i dt.02.10.2014.
9. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web faqën zyrtare të Komunës konform Rregullores së QRK nr.10/2019 –Shtojca II-Lista 1.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr 221-16306 /2021
Klinë me 27.05 /2021



KRYESUESI,
Fadil Gashi